

V E N D I M
Nr. 357, datë 18.7.2002

**PËR DHËNIEN E STATUSIT “SPITAL UNIVERSITAR”, SPITALIT USHTARAK
QENDROR**

Në mbështetje të pikës 2 të neni 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.3766, datë 17.2.1993 “Për shërbimin shëndetësor dhe dhënie falas të ndihmës mjekësore të shtetit”, të neni 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8718, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Spitalit Ushtarak Qendror i jepet statusi “spital universitar” dhe emërtohet “Spitali Ushtarak Qendror Universitar” (SUQU).
 2. Spitali Ushtarak Qendror Universitar funksionon me këtë strukturë organizative:
 - a) Spitali Ushtarak (SU);
 - b) Instituti i Kërkimeve Mjekësore Ushtarake (IKMU);
 - c) Qendra Kombëtare e Traumatologjisë (QKT).
 3. Drejtori i Përgjithshëm i Spitalit Ushtarak Qendror Universitar është mjek ushtarak dhe emërohet e lirohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes.
 4. Buxheti i Spitalit Ushtarak Qendror Universitar përcaktohet zë më vete në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.
 5. Këshilli i Ministrave miraton rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar.
 6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko